



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QËNDRORE

Adresa "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr.679/6 Prot.

Tiranë, më29/ 09/ 2018

PROJEKT

V E N D I M

Nr.151, Datë 29.09.2018

PËR
AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË
TË USHTRUAR NË SHËRBIMIN KOMBËTAR TË PUNËSIMIT,
për periudhën 01.01.2016 deri më 31.03.2018

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit rezultoi se, në përgjithësi në institucion është vepruar në përputhje me rregullat, kuadrin ligjor dhe dispozitat e tjera që normojnë veprimtarinë ekonomike dhe administrative. Krahas anëve pozitive u konstatuan dhe të meta e mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/anomali materiale por jo të përhapura në zbatimin e kërkesave të kontabilitetit, anomali në plotësimin e pasqyrave financiare, mungesa të akteve nënligjore apo nevoja për përmirësimin e tyre.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, sipas programit të auditimit nr. 679/1, datë 08.06.2018 i ndryshuar, për veprimtarinë e ushtruar nga data 01.01.2016 deri më 31.03.2018.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A.OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin:

KLSH ka audituar veprimtarinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 4000², si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe atij financiar të KLSH.

SHKP është përgjegjës për menaxhimin e hartimit të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Përgjegjësia e auditimit është të shprehë bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se aktiviteti është kryer në përputhje me kuadrin rregullativ dhe se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Ky opinionin është mbështetur në dëshmitë e evidencës së auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

I. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara *jo materiale e jo të përhapura, për të cilën japim opinion të pa kualifikuar*³”

II. Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë⁴:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të SHKP Tiranë në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara *jo materiale e jo të përhapura, për të cilën japim opinion të pa kualifikuar me theksim çështje*⁵”.

¹ -ISSAI 1700- Objektiv i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² -ISSAI 4000 – Objektiv i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

³ - Sipas *Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së*, kapitulli IV, pika 4.1.2, “Audituesi do të shprehë një opinion të pakualifikuar kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar..

⁴ -Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

⁵ -Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së*, kapitulli V, pika 5.4, *Konkluzionet/ opinionet e pa kualifikuara, theksimi i çështjeve dhe çështje të tjera (faqe 71):* N.q.s. audituesi konsideron se është e nevojshme të tërheqë vëmendjen e palës së interesuar për një çështje të paraqitur ose publikuar në informacionin mbi drejtimin e auditimit që, sipas gjykimit të audituesit, është e një rëndësie të tillë sa që përbën arsye themelore për palën e interesuar që të kuptojë informacionin mbi drejtimin e auditimit, audituesi shton një paragraf me theks mbi këtë çështje.:

E gjykojmë të arsyeshme të cilësojmë, çështjen specifike, sa vijon:

Nga fondet e buxhetit të shtetit akordohen për nxitjen e punësimit disa programe të specifikuara në mbështetje të kuadrit ligjor, por sipas VKM- së nr. 47, datë 16.01.2008 “*Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë*” i ndryshuar, është përcaktuar se përfitues të këtij programi janë punëkërkues të papunë, të cilëve SHKP nëpërmjet zyrave rajonale të punësimit, u financon përveç pagesave dhe shumë 19,000 lekë si tarifë me bazë koston për çdo muaj trajnimi deri në 6 muaj. Në kushtet kur nuk kërkohet asnjë dokumentacion i specifikuar mbi mënyrën e justifikimit të kostove të trajnimit, (pjesë e subvencionit), krijohen premisa e mundësi për veprime të parregullta dhe përfitime të padrejta e abuzive nga subjektet private dhe njësitë e biznesit, si përfitues të këtyre fondeve, duke u kthyer në fonde buxhetore të ekspozuara me risk të lartë.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1.-Gjetje nga auditimi:

Në bazë të VKM nr. 47, datë 16.01.2008 “*Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë*”, i ndryshuar, përfitojnë nga ky program të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit që kërkojnë të kualifikohen profesionalisht nëpërmjet punës.

Sipas VKM-së, punëkërkuesit e papunë përfitojnë financim (50% të pagës minimale në shkallë vendi për periudhën e formimit nëpërmjet punës me një kohëzgjatje deri në 6 muaj, në varësi të fushës së aktivitetit dhe për kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë në masën e përcaktuar nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore, për periudhën e formimit).

Punëdhënësit, gjithashtu, përfitojnë (për çdo punëkërkues të papunë pjesëmarrës në program, subvencionin në masën 19.000 lekë/muaj për çdo muaj formim, për blerjen e lëndës së parë dhe për planet e trajnimit, etj, të cilat subjekti privat përfitues do t'ia ofrojë punëkërkuesve, gjatë praktikave trajnuese.

Vlera e subvencionit për tarifën me bazë kosto, në masën 19,000 lekë/ muaj për person zë gati 78% të vlerës së projektit (programit të nxitjes së punësimit), për të cilat, **mungon kuadri nënligjor me detyrimin e subjekteve përfituese për dokumentimin, justifikimin, si dhe dorëzimin e praktikave që vërtetojnë shpenzimin e shumës së subvencionimit, të përfutur nga Buxheti i Shtetit.**

Kjo situatë ka ardhur kryesisht nga shfuqizimi i pikës nr. 6, të Vendimit të KM nr. 47, datë 16.01.2008 me VKM-së nr. 65, datë 27.01.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 47 / 2008”, në të cilën më parë përcaktohej se:

“Kostoja e trajnimit përcaktohet nga një komision i ngritur në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe në të përfshihen:

a)Kostoja personale e trajnuesve, e cila është deri në 1.5 herë më e lartë se tarifa shtetërore e miratuar, sipas akteve nënligjore në fuqi;

b)Shpenzimet e udhëtimit të trajnuesve dhe të trajnuarve, sipas akteve nënligjore në fuqi;

c)Baza materiale, ku bëjmë pjesë materialet e nevojshme për zhvillimin e kursit dhe kostoja e shërbimit, për udhëzim dhe këshillim, që lidhen me projektin e trajnimit;

ç)Amortizimi i mjeteve dhe i pajisjeve gjatë përdorimit, vetëm për projektin e trajnimit

Kostot duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, transparente dhe të specifikuara, sipas elementeve të përcaktuar më sipër.”

Nga verifikimi i dosjeve fizike të 19 (nëntëmbëdhjetë) subjekteve përfitues, mbi ecurinë dhe monitorimin e programeve (projekteve) të nxitjes së punësimit pranë tre DRSHKP-ve, Tiranë, Fier dhe Vlorë, rezulton se, për dy vitet buxhetore 2016 dhe 2017, vlera e subvencionit të përftuar nëpërmjet programeve (projekteve) sipas VKM nr. 47, datë 16.01.2008, arrin vlerën prej 125,129,400 lekë dhe se nuk kishte asnjë dokumentacion justifikues financiar për pasqyrimin e përdorimit të këtij subvencioni. *Më hollësisht trajtuar në pikën V, faqe 63-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1- Rekomandimi

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në bazë të rolit që ka sipas ligjit për nxitjen e punësimit,

a. Të propozojë ndryshimet e nevojshme pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si ministria përgjegjëse për nxitjen e punësimit dhe që ka përgjegjësinë e propozimit të akteve nënligjore për fushën e përgjegjësisë shtetërore, në përmirësim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 16.01.2008 “*Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë*”, i ndryshuar, ku të gjejë rregullim fakti që, kostot e subvencioneve shtetërore për blerjen e lëndës së parë të cilat subjekti privat përfitues do t’ia ofrojë punëkërkuessve, gjatë praktikave trajnuese, duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, transparente dhe të specifikuara, sipas elementeve përbërës të saj.

b. Të marrë masat për të rishikuar dhe përmirësuar dokumentacionin bazë që formon gjurmën e auditimit për proceset e përfitimit të fondeve nga nxitja e punësimit, duke rishikuar udhëzimet, rregulloret dhe kontratat tip të miratuara nga Këshilli Administrativ Trepalësh (KAT), në funksion të përcaktimit të skedës së dokumentacionit të domosdoshëm justifikues për shumën 19 mijë lekë që përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për çdo pu.pa për trajnim, dokumentacion që subjektet private përfituese duhet të depozitojnë pranë Drejtorive Rajonale të Punësimit.

Brenda 4 muajve

C. MASA ORGANIZATIVE:

1.-Gjetje nga auditimi:

1.1. Për periudhën objekt auditimi Drejtoria e Përgjithshme e SHKP Tiranë ka ekzekutuar 49 vendime gjyqësore të formës së prerë me vlerë 30.222.476 lekë për ish-punonjësit, që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj institucionit për vendimin e largimit nga puna. Nga auditimi konstatohet se,

- Për vitin 2016, vlera në total për ekzekutim të 17 vendimeve gjyqësore është 14.660.690 lekë, likuiduar nga fondet e akorduara nga Ministria e Financave.

- Për vitin 2017 vlera në total për ekzekutim të 30 vendimeve gjyqësore është 14.454.584 lekë

- Për 3 mujorin janar-mars 2018, vlera në total për ekzekutim të 2 vendimeve gjyqësore është 530.434 lekë.

Likuidimi i ish-punonjësve që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna për vitin 2016 dhe 2017 është bërë në 11 raste nëpërmjet ekzekutimit vullnetar nga institucioni dhe në 38 raste nëpërmjet zyrave përmbarimore.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.2. Nuk janë rakorduar plotësisht të dhënat mbi detyrimet dhe likuidimet për vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë të administruara nga Sektori i Financës me data basën

që administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Konkretisht, sipas kësaj të fundit, janë 42 vendime gjyqësore, (*shumica me objekt dëmshpërblimet për ndërprerje të padrejtë të marrëdhënieve të punësimit dhe janë pjesë e anekseve të raportit të auditimit*), nga të cilat 18 janë të formës së prerë për vitin 2016 dhe 2 janë të tilla nga viti 2017. Evidentohet se, nuk janë përcjellë për tu kontabilizuar pranë Sektorit të Financës disa vendime, për të proceduar me skedulimin e afateve dhe vlerave të tyre për shlyerjen e detyrimeve. *Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1. Rekomandimi

1.1. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Financës, në çdo rast, me marrjen dijani për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrin masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

1.2. Të merren masat për rakordimin e të dhënave midis drejtorive dhe sektorëve të SHKP në lidhje me regjistrimin, kontabilizimin në kohë dhe ndjekjen e ecurisë së proceseve dhe vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke zbatuar detyrimet e legjislacionit për sistemin buxhetor publik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.-Gjetje nga auditimi:

2.1. Nisur nga fakti që, një kategori e caktuar projektesh janë ndjekur nga kryerja e rikonstruksioneve dhe janë në funksionin konkret të një aktivi, siç është “*Studim projektimi për ndërtimin e ri të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Nr. 4 Tiranë*”, vlera prej 1,827 mijë lekë duhet tranzituar nga AAJM tek AAM, meqenëse është kryer likuidimi për subjektin “A.C” SHPK. Si rrjedhojë, pas përfundimit të rikonstruksionit, vlera e projektit duhet të kontabilizohet si pjesë e kostos historike të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM), si dhe të amortizohet së bashku me vlerën e objektit për të cilin është kryer ky projekt, referuar përcaktimeve të Manualit të Klasifikimit Ekonomik, se:

“Duhet të kihet parasysh të dallohen projektet e blera ose të krijuara si të tilla (p.sh projekt për një standard rruge), të cilat konsiderohen si aktive të trupëzuara, nga projektet pjesë e kostos historike të aktiveve të trupëzuara të krijuara (p.sh: projekti për ndërtimin e një rruge të caktuar), të cilat konsiderohen si aktive të trupëzuara” si dhe SKK nr. 5, që këto natyra shpenzimesh i njeh si kosto që i ngarkohet drejtpërdrejt përgatitjes së aktivitetit për përdorimin e tij të paramenduar”.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2.1. Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” vlera e studim-projektimit të lidhur me QFP nr.4, referuar kontratës së nënshkruar midis SHKP dhe subjektit privat “P.C” SHPK është 1,827 mijë lekë, (sipas faturës tatimore nr. 36, datë 29.09.2016 si dhe urdhër shpenzimit nr. 231, datë 21.10.2016), ndërsa në pasqyrat financiare të SHKP është pasqyruar në vlerën 2,000 mijë lekë. Për sa sipër, është kontabilizuar më tepër në bilancin e vitit 2016 dhe 2017,

vlera prej +173 mijë lekë, pa u mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm justifikues. *Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.2.2. Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” të bilancit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit nuk janë reflektuar vlerat e studimeve dhe projekteve, që në fakt janë pasqyruar në të dhënat mbi investimet (Sektori i Buxhetit) për vitin 2016 dhe 2017. Konkretisht:

Nga auditimi i të dhënave mbi realizimin e buxhetit analitik për v. 2016, evidentohet se vlera e kategorisë “*Studimet dhe projekte për administratën qendrore të SHKP*” është 2,391,600 lekë, ku përfshihet vlera prej 2 milionë lekë (në funksion të QFP nr. 4) si dhe 4 studime e projekte, të kryera përkatësisht DRSHKP Tiranë për 96 mijë lekë, DRSHKP Fier për 98 mijë lekë, DRSHKP Vlorë për 98 mijë lekë, DRSHKP Gjirokastër për 99, 6 mijë lekë.

Pra, rezulton një diferencë prej (2,000,000-2,391,600 lekë), sa evidentuar më pak -391,600 lekë në llogarinë 230 “*AQPT/ AAJM*”, vlera e studimeve dhe projekteve të realizuara nga Drejtoritë Rajonale, por që nuk janë përfshirë në bilanc.

Përfundimisht, për sa kontabilizuar më tepër se fatura tatimore në llog.230 vlera prej +173 mijë lekë, pa u mbështetur në dokumentacionin e duhur justifikues, si dhe nga ana tjetër, sa evidentuar më pak në llogarinë 230 “*AQPT/ AAJM*”, vlera prej -391,6 mijë lekë (studime dhe projekte të realizuara nga drejtoritë rajonale dhe nuk janë përfshirë në bilanc), nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” me ndryshimet si dhe përcaktimet e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale*”, i përmirësuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.3. Në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” është përfshirë vlera bruto e studimeve dhe projekteve prej 2,000,000 lekë, për të cilën nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara që nga viti 2016 që shënon marrjen e këtyre shumave në llogarinë e aktiveve, si dhe për vitin 2017.

Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale*”, i përmirësuar; kërkesat e Kapitullit III, Seksioni II, “*Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara*”, të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël*”, ku në lidhje me regjistrimet kontabël për aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara përcaktohet se: “*Ligji për “Për kontabilitetin “parashikon një kufizim të afatit për amortizimin e këtyre aktiveve (deri në 5 vjet) nisur nga rreziqet që mund t’i vijnë kreditorëve të njësisë ekonomike në rast të një falimentimi, sepse disa elemente janë të pashitshme (p.sh. shpenzimet e nisjes e të zgjerimit¹), ose bëhen të pashitshme apo të pavlershme (p.sh. fondi tregtar). Megjithatë për elemente që gëzojnë një mbrojtje ligjore ose janë të lidhura me një element tjetër të trupëzuar amortizimi mund të bëhet në një afat më të gjatë”.*

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. -Rekomandimi

Nga ana e Sektorit të Financës të analizohen me përgjegjësi elementet e Aktiveve të Qëndrueshme të Patrupëzuara (AQPT ose AAGJJM), të identifikohen zërat analitikë që klasifikohen si të tilla dhe të merren masat për sistemimet e nevojshme në kontabilitet në llogarinë 202 dhe 230 (sa kontabilizuar padrejtësisht vlerat më tepër dhe më pak sa sipër), dhe të reflektojnë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare që do të mbyllen për vitin buxhetor në vijim.

Me mbylljen e pasqyrat financiare të vitit 2018

3.-Gjetje nga auditimi:

Nga analiza e llogarisë 210, “*Toka, troje e terrene*” rezulton se vlera e saj prej 11 milionë lekë është kontabilizuar që në vitin 2000, (dhe paraqitet për të njëjtën shumë gjatë periudhës objekt auditimi). Regjistrimi në kontabilitetin e institucionit të sipërfaqes së truallit është bërë pa shënuar asnjë të dhënë mbi sipërfaqen që i takon institucionit ndaj sipërfaqes së përgjithshme dhe pa caktuar çmimin e përlllogaritur për njësi të sipërfaqes në kushtet e bashkëpronësisë mbi këtë sipërfaqe jo vetëm të këtij institucioni, edhe të qytetarëve të tjerë.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit për bashkëpronësinë në banesa, në fuqi respektivisht sipas periudhave, si më poshtë:

-Kreu I, neni 3, germa “ç”, të ligjit nr. 7688, datë 13.3.1993 “Për bashkëpronësinë në banesa”, sipas të cilit, “..... *Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, që nuk janë destinuar për përdorim individual, si truallin mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset dhe depozitat e ujit. etj..*

dhe

-Neni 5, “Objekte në pronësi të përbashkët”, të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, ku theksohet se, “*Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat*”.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 41-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3- Rekomandimi

3.1. Drejtori i Përgjithshëm të ngrejë një grup pune me ekspertë të fushës për të evidentuar dhe saktësuar sipërfaqet e përgjithshme të tokës truall që i përket Drejtorisë së Përgjithshme të SHKP dhe vlerat respektive të saj, dokumentuar me planimetri dhe genplane të hollësishme.

3.2. Të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit ose korigjimit të vlerave në kontabilitetin e institucionit, në mbështetje të kontratës së blerjes si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” duke evidentuar situatën reale në pasqyrat financiare të institucionit, në pajtueshmëri dhe me legjislacionin për bashkëpronësinë në banesa.

Brenda 3 muajve

4.-Gjetje nga auditimi:

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe llogarive të kontabilitetit konstatohet se, mbas realizimit të investimeve në ambientet e godinës së re të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional nr. 4 Tiranë, nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është lëshuar Urdhri nr. 109, datë 03.04.2018 “Për kalimin në administrim të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë të ambienteve të godinës së re në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional nr. 4 Tiranë”. Për sa sipër, nga DRFP nr.4 është lidhur me datën 24.4.2018 marrëveshja dy palëshe për dhënien e ambienteve të reja sipas planimetrisë për Dhomën Kombëtare të Zejeve dhe se afati i vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 2 të saj, është nga data e nënshkrimit dhe do të zgjasë “*përsa kohë është në fuqi baza ligjore e mësipërme*”. Ky veprim nuk justifikon investimin prej **80,295,084 lekë** pa TVSH, të realizuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit,

duke ndryshuar destinacionin nga qendër profesionale, në ambiente për zyra të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë (DHKZ).

Audituesit e KLSH-së sjell në vëmendje se:

DHKZ është person juridik që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse dhe funksionon sipas ligjit nr. 70 /2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në bazë të nenit 40, “Financimi i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë”, përcaktohet se “*Dhoma Kombëtare e Zejtarisë financohet nga*

-Kuotat e anëtarësisë;

-Tarifat për shërbimet që ajo ofron;

-Çdo financim tjetër i ligjshëm”.

Gjithashtu, sipas cilësimeve të pikës nr. 3, të Nenit 23, “*Dhoma kombëtare e zejtarisë mund të blejë dhe të zotërojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në funksion të saj*”.

Pra, në ligj nuk ka asnjë detyrim të organeve shtetërore për ti kaluar DHKZ prona e ambiente në administrim të saj, ndaj ky veprim nuk është i justifikuar ligjërisht.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. 1. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm të analizojë këtë situatë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe QFP nr. 4 Tiranë, në përputhje me përcaktimin e nenit 45 të ligjit nr.70 / 2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”, me kalimin e afatit dy vjeçar të marrë masat për lidhjen e kontratës së qiradhënies.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.-Gjetje nga auditimi:

Gjatë viteve që janë objekt auditimi, një pjesë e detyrimeve të lindura apo faturave të lëshuara për shpenzimet e kryera 2017, janë likuiduar në periudha të vitit pasardhës (2018). Vlera e detyrimeve të mbetura pa u likuiduar, përgjithësisht është kontabilizuar si angazhim për tu paguar në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Megjithatë, rezulton të jenë kryer pagesa dhe likuiduar në vitin 2018 detyrime të vitit 2017, por pa i paraqitur më parë si detyrime në bilanc. Konkretisht, vlefta e faturave të likuiduara por të pa kontabilizuara në bilancin e mëparshëm është 1,119,877 lekë, kurse në pasqyrat financiare të v. 2017 janë regjistruar vetëm 720,983 lekë. Për rrjedhojë, janë evidentuar dhe regjistruar më pak në kontabilitetin e v. 2017, detyrimet prej -398,894 lekë. Sa sipër, vepruar në kundërshtime me kërkesat e Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar si dhe Nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016. Edhe pse sa më sipër nuk ka impakt financiar, kontabiliteti rritës vlerësohet të jetë efektiv për menaxhimin financiar dhe aktivitetet e kontrollit. Mos raportimi mbi baza të kontabilitetit rritës rrezikon të cenojë cilësinë dhe koherencën e ndryshimit të gjendjes pasurore të institucionit të audituar kundrejt krijimit të të drejtave apo detyrimeve financiare, për qëllime vendimmarrjeje.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1. Rekomandimi

Nga ana e Sektorit të Financës të merren masat që, në mbajtjen e kontabilitetit, të aplikohen në mënyrë të saktë e të besueshme rregullat kontabël, mbështetur mbi bazën e parimit të kontabilitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe standardeve të zbatueshme për mbajtjen e kontabilitetit mbi baza monetare

Në vazhdimësi

6.-Gjetje nga auditimi:

Në aktivin e bilancit kontabël llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur në vlerën zero lekë. Përsa më lart rezulton se nuk janë regjistruar në kontabilitetin e institucionit, detyrimet për llogarinë 468 “Debitor në persona”, në vlerën e përgjithshme prej 1,007,500 lekë, referuar konkluzioneve të auditimit të dërguara nga ana e KLSH sipas shkresës nr. 1135/10 prot, datë 29.06.2016, ku është përcaktuar detyrimi që të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për vlerën 1,007,500 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. 1. Rekomandimi

Drejtoria e Përgjithshme e SHKP të marrë masat për analizimin dhe ndjekjen e procedurave për vënien në kushtet e arkëtimit të shumës prej 1,007,500 lekë, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.-Gjetje nga auditimi:

-Nga ana e Drejtorit të SHKP, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për periudhën objekt auditimi, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për MFK”.

-Evidentohet se janë përmbushur detyrimet, në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për hartimin e regjistrit të riskut për vitin 2016 dhe 2017, sipas kërkesave të neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, mirëpo ky dokument duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi si dhe të dërgohet në Ministrinë e Financave, konformë përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

- Nuk janë marrë masat për hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Risqeve, detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji, i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme menaxheriale dhe monitorimin e objektivave të njëjësive publike, përfshirë dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 21, pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshimet, ku përcaktohet se, “Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, miraton një strategji e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues, analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 55-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7. 1. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm i SHKP të marrë masa që të plotësohet regjistri i riskut me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit të MFE, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, në përputhje me kërkesat e kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe në koordinim me ministrinë e linjës, të azhurnojë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut së bashku me planin e veprimit për arritjen e objektivave të programit, e cila të përditësohet rregullisht (çdo tre vjet), ose kur në mjedisin e institucionit ndodhin ndryshime të rëndësishme.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 55-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vazhdimësi

8.-Gjetje nga auditimi:

Konstatohen dobësi dhe parregullsi si në kompozimin, ashtu dhe në organizimin e Strukturës së Auditimit të Brendshëm në SHKP. Rezulton se struktura e auditimit është në nivel sektori dhe sipas organigramës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 2, datë 07.01.2014, është me tre punonjës dhe pa drejtues. Mungesa e pozicionit të përgjegjës të sektorit mbart risk operacional dhe mund të çojë në mosrealizimin e detyrave të parashikuara, pengon procesin e menaxhimit efektiv të kapaciteteve audituese, pengon procesin e miratimit të planeve dhe programeve të angazhimit si dhe pengon sigurimin e kontrollit të brendshëm të cilësisë. *Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me:*

a. Standardet Ndërkombëtare Profesionale të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;

b. Përcaktimet e pikës nr.3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku theksohet se, “*Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë.*”.

c. Përcaktimet e pikës nr. 22, të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, ku theksohet se, “*Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës*”.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit të marrë masa të menjëhershme që, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të propozojnë korrigjimin e organikës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të SHKP, të miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr. 2, datë 07.01.2014, duke rikompozuar strukturën e auditimit dhe krijuar pozicionin e drejtuesit të njësisë, në përputhje me përcaktimet e pikës nr.3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

9.-Gjetje nga auditimi:

9.1. Për vitet buxhetore 2016 dhe vitin 2017, SHKP ka funksionuar sipas Urdhrit Nr. 2, datë 07.01.2014 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 91, datë 28.10.2011 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, ku në organikë janë vetëm 2 (dy) specialistë për nxitjen e punësimit pranë Drejtorisë së Programeve

të Integritimit në Tregun e Punës, *numër ky i pamjaftueshëm në burime njerëzore për realizimin e komponentit të monitorimit në terren të programeve të nxitjes*. Gjithashtu konstatohet se, edhe pranë Drejtorive Rajonale të SHKP/ Zyrave Vendore, të cilat, midis të tjerave, kanë për detyrë funksionale ndjekjen e zbatimit të kontratave me subjektet përfituese nga programi, sipas strukturave organike është vetëm 1 (një) specialist i shërbimeve të punësimit që merret me monitorimin e ecurisë së programit për subjektet përfituese (me përjashtim të DRSHPK Tiranë ku sektori është me 3 punonjës).

9.2. Në bazë të VKM-së nr. 65, datë 27.01.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 47, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave , është shfuqizuar pika 6 e VKM nr. 47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar, duke sjellë për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, *dobësimin e komponentit të monitorimit*, me dokumentacion justifikues financiar nga subjektet përfituese, mbi subvencionimin e përfutur nga Buxheti i Shtetit. Ekzistenca e strukturave organike me kapacitet të pamjaftueshëm për monitorimin e programeve të nxitjes së punësimit, (Shërbimi Kombëtar i Punësimit me njësitë e varësisë), ka sjellë dobësi dhe mungesa në mbulimin me monitorim të plotë të subjekteve përfituese, në lidhje me fondet buxhetore të përfutuara.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 55-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1. Rekomandimi

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit të marrë masa të menjëhershme që, të bëjë propozimet për korigjimin e organikës së SHKP, të miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr. 2, datë 07.01.2014, duke krijuar e kompozuar strukturat për monitorimin e programeve, duke analizuar e studiuar numrin optimal të punonjësve që nevojitet për monitorimin e këtyre programeve si në Drejtorinë e Përgjithshme, ashtu dhe Drejtoritë Rajonale të Punësimit.

Menjëherë

10.-Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se,

a. Për shkak të mos krijimit dhe miratimit të ekipit të menaxhimit të programit nuk është hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit si dhe aktivitetet e programit, gjithashtu çdo program nuk ka të përcaktuar produktet programeve buxhetore.

b. Hartimi i PBA-ve për periudhën objekt auditimi ka mangësi në trajtimin e tyre, të tilla si *përshkrimi i misionit të njësisë, përshkrimi i programeve dhe veprimtarive të njësisë, paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës së performancës, planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve dhe aktiviteteve si dhe treguesit faktik për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin në vazhdim si dhe për tri vitet e ardhshme buxhetore*, në kundërshtim me pikën 6, të Udhëzimit të MF nr 23. datë 22.11.2016.

c. Nga institucioni për periudhën objekt auditimi është dërguar vetëm faza e dytë e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, duke mos dorëzuar në Ministrinë e linjës fazën e I të planifikimit të buxhetit afatmesëm, në kundërshtim me Kapitullin III të Udhëzimit të MF nr. 23, datë 22.11.2016 “Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm” ku janë përshkruar fazën e parë e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm si dhe janë detajuar afatet.

Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 10-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10. Rekomandimi

10.1. Institucioni të marrë masa që gjatë hartimit të PBA-ve të sigurojë që, alokimet e buxhetit të reflektojnë prioritetet gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare), duke bërë një

lidhje të drejtpërdrejtë midis alokimit të buxhetit dhe objektivave të politikës së programit, si dhe duke përcaktuar qartë prioritetet, objektivat, masat që do të merren për arritjen e këtyre objektivave si dhe kërkesat shitesë për secilin program buxhetor, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar; dhe pikës nr. 6 të UMF nr. 23, datë 22.11.2016 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA”.

10.2. Nëpunësi autorizues të marrë masa, ku referuar pesë programeve buxhetore të institucionit, të miratojë GMS, drejtuesit e Programeve si dhe Ekipin e Menaxhimit të Programeve, duke bërë të mundur njohjen e përgjegjësive dhe detyrave të drejtuesit të çdo programi, në lidhje me hartimin e kërkesave buxhetore, për realizimin e qëllimeve, objektivave si dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Nga ana tjetër, të merren masa për hartimin dhe miratimin e Deklaratës së Politikës së Programit, e cila përbëhet nga Qëllimi i Politikës së Programit, Objektivat dhe Treguesit e Performancës

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11.-Gjetje nga auditimi:

11.1. Buxheti i vitit 2016, në total nga 2,158 milionë lekë që ishte buxheti i miratuar, është realizuar për 1,801 milionë lekë, ose në masën 83,5%. Analizuar me buxhetin e rishikuar, nga 1,852 milionë lekë, është realizuar 1,801 milionë, ose në masën 97%. me një mosrealizim prej 51,4 milionë lekë. Konstatohet se, me nivel të ulët realizimi janë në programet “pagesë papunësie” ne masën 96%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën 26,5 milionë lekë) dhe programet “nxitje punësimi” ne masën 97%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën 13,5 milionë lekë).

Buxheti i vitit 2017, në total nga 2,290 milionë lekë që ishte miratuar, është realizuar për 1,455 milionë lekë, ose në masën **63.53%**. Analizuar me buxhetin e rishikuar, nga 1,687 milionë lekë, është realizuar 1,455 milionë, ose në masën 86%. **Këto të dhëna tregojnë një performancë të ulët buxhetore.** Analizuar kundrejt treguesve të buxhetit të miratuar, rezulton me një mosrealizim prej 835 milionë lekë, ndërsa krahasuar me treguesit përfundimtar të buxhetit (pas alokimeve dhe transferimeve), masa e mosrealizimit paraqitet prej 231 milionë. Me nivel më të ulët realizimi gjatë këtij vitit janë programet “pagesë papunësie” ne masën 64%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën 191 milionë lekë), programet “formim profesional” ne masën 94%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën 15,2 milionë lekë) dhe programet “nxitje punësimi” ne masën 97%, (ku mosrealizimi i fondeve është në vlerën 15 milionë lekë).

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 30-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.2. Nga analiza e shpenzimit të buxhetit për këtë program për v.2016, evidentohet se disa njësi rajonale paraqiten me tregues më të dobët në realizimin e fondeve për nxitjen e punësimit, të tilla si, DRSHKP Elbasan me nivel realizimi 94 %, ose me mosrealizim të fondeve prej -1,004,579 lekë; DRSHKP Fier me 95 %, ose me mosrealizim të fondeve prej -5,199,023 lekë; DRSHKP Vlorë me nivel realizimi 92 %, ose me mosrealizim të fondeve prej -1,417,184 lekë; DRSHKP Tiranë me nivel realizimi 98 %, ose me mosrealizim të fondeve prej -2,789,287 lekë etj,

Nga analiza e shpenzimit të buxhetit për këtë program për vitin 2017, evidentohet se në shumën e mosrealizimeve prej 15 milionë lekë, disa njësi rajonale paraqiten me tregues më të dobët në realizimin e fondeve për nxitjen e punësimit, të tilla si, DRSHKP Shkodër me nivel realizimi 93 %, ose me mosrealizim të fondeve prej -1,893,456 lekë; DRSHKP Vlorë me nivel realizimi 89%, ose me mosrealizim të fondeve prej -2,348,357 lekë; DRSHKP Tiranë me nivel realizimi 94 %, ose me mosrealizim të fondeve prej -8,085,907 lekë;etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 30-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.3. SHKP nuk i ka bërë publike këto raporte në ëebfaqen e saj dhe të ministrisë së linjës. Ndaj, vlerësimi i auditimit për këtë indikator është se, ndonëse raportet e monitorimit të këtij institucioni i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin, ato nuk janë bërë publike për v.2016 dhe v.2017.

11.- Rekomandimi

11.1. Nga ana e SHKP të analizohen dhe nxirren përgjegjësitë për drejtuesit e disa drejtorive rajonale që paraqiten me tregues të ulët të performancës në realizimit të fondeve të programit për nxitjen e punësimit, kjo e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikave shtetërore për këtë qëllim.

11.2. Nga ana e drejtuesve të SHKP dhe sektorit të buxhetit të merren masat që në përputhje me kuadrin nënligjor mbi buxhetimin, raportet e monitorimit të bëhen publike dhe të vendosen në faqen zyrtare të institucionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.-Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me plotësimin dhe administrimin e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si *CV, diplomë, listë notash, certifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi* etj. Në DP e SHKP, për periudhën objekt auditimi, janë depozituar vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve në zbatim të 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe VKM nr.116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”. Dosjet personale të nëpunësve janë administruar duke mos përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe të manualit mbi arkivimin e dokumenteve. Dosjet e personelit nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të veçantë, sipas kërkesave të Kapitullit V, Formatit Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje, etj. Dosjet e personelit të SHKP nuk përmbajnë në çdo rast dokumentacion të plotë, mungon fleta prezantuese e dosjes, certifikata e gjendjes familjare, fleta e inventarit është e pafirmosur dhe një pjesë e këtyre dokumenteve janë fotokopje të pa noterizuara. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, (*lidhja nr.1, pikat 2, 3a, 4 dhe 5*).

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12.1. Rekomandimi

Strukturat përgjegjëse të SHKP të marrin masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve personale të nëpunësve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe manualit “Mbi arkivimin e dokumenteve” dhe aktet e tjera që normojnë këtë proces

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.-Gjetje nga auditimi:

Konstatohet se, për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, por nga ana e institucionit janë paguar kosto shtesë për zyrat përmarimore, e cila për periudhën objekt auditimi paraqitet në vlerën **1,461,364 lekë**, shumë kjo që konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit

Për sa sipër, për 36 raste, nuk janë zbatuar procedurat e parashikuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, pika nr 2, ku përcaktohet se, “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre” si dhe pika nr. 5, sipas të cilës njësitë shpenzuese detyrohet të ekzekutojë në mënyrë vullnetare vendimin gjyqësor të formës së prerë, sipas afateve të parashikuara në nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile, pasi përndryshe shtohen kostot buxhetore meqenëse përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi:

Strukturat e drejtimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të analizojnë dhe marrin masat për likuidimin në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe të mos përsëriten situatat që shoqërohen me shtimin e kostove buxhetore nga pagesat e përmbaruesit gjyqësor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH, rezulton se nuk janë arkëtuar detyrimet në vlerën **1,007,500 lekë**, nga punonjës, të cilët kanë një detyrim të caktuar ndaj institucionit, krijuar nga auditimi i ushtruar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit (shkresa nr. 1135/12, datë 04.07.2016). Kështu, janë 31 persona/subjekte debitorë ndaj SHKP, dhe në lidhje me këto detyrime institucioni **nuk i ka pranuar si detyrime, nuk i ka regjistruar ato dhe nuk ka mundur të arkëtojë këto vlera detyrimesh të krijuara nga viti 2014-2015**, por institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin dhe menaxhimin e debitorëve, siç përcaktohet në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi

Shërbimi Kombëtar i Punësimit të analizojë dhe rivendosë në afat procedurat për të mundësuar vënien në kushte arkëtimi të detyrimeve të krijuara nga raportet e auditimit të ushtruar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Spektori i Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa, që të analizojnë situatën e këtyre detyrimeve dhe të hartojnë një planveprimi për zgjidhjen e situatave të krijuara dhe të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve.

E.PËR KRYERJEN E AUDITIMIT TË PËRFORMANCËS NË SHKP

Përgjatë vitit 2019, Departamenti i Performancës do të zhvillojë një auditim performance në këtë institucion me fokus mbi efektivitetin e fondve të akorduara nga buxheti i shtetit për nxitjen e punësimit dhe kualifikimit/trajtimin nëpërmjet punës për punëkërkuesit e papunë të regjistruar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Grupi i Auditimit

**Valentina GOLEMI
Qeram CIBAKU
Valentina SULA**

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R